



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 64/15 Prot.

Tiranë, më 2.03.2017

VENDIM

Nr. 42, datë 2 / 3/2017

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të Ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e Informimit", shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar, ligjin nr.10279, datë 20.05.2010 "Për kundërvajtjet administrative", Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale,

V Ë R E N:

Ankuesi, Z. _____, përfaqësuar me Autorizimin datë 12.01.2017 nga Z. _____, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim quajtur "Komisioneri") "Formularin e Ankesës nr.64/2 Prot., datë 19.01.2017, me objekt "Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare", kundër Autoritetit Publik "Korporata Elektroenergjetike Shqiptare" (në vijim quajtur "Autoriteti Publik").

Ankuesi, nëpërmjet shkresës datë 30.12.2016, ka paraqitur pranë Autoritetit Publik, kërkesën për informacion si më poshtë:

- *Kopje të të gjithë dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik 4A-M shpk në procedurën e prokurimit me objekt "Krijimi i sistemit të monitorimit hidrometrologjik në kaskadën e lumit Drin";*
- *Kopje të të gjithë dokumentacionit të paraqitur nga ofertuesi Fondazione CIMA në procedurën e prokurimit me objekt "Krijimi i sistemit të monitorimit hidrometeorologjik në kaskadën e lumit Drin";*

Ankuesi pretendon se është cënuar në të drejtën për informim, pasi nuk është informuar lidhur me sa ka kërkuar dhe për këtë arsye ka depozituar ankim pranë Komisionerit.

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, Komisioneri, pas verifikimit të ankimit, me urdhrin nr.26, datë 30.01.2017, ka urdhëruar kryerjen e inspektimit administrativ pranë Autoritetit Publik.

Gjatë inspektimit është konstatuar se kërkesa e Z. _____ është depozituar pranë Autoritetit Publik dhe është regjistruar me nr.10308 Prot., datë 30.12.2016. Grupi i inspektimit konstatoi se Autoriteti Publik nuk e ka trajtuar kërkesën e Z. _____

Pas kontaktit me përfaqësuesin e Autoritetit Publik, u sqarua se dokumentacioni i kërkuar nuk përbën informacion publik dhe për këtë arsye nuk i është vendosur në dispozicion kërkuarit.

Gjithashtu ky i fundit sqaroi se informacioni i kërkuar përmban sekret tregtar, për të cilin nuk disponohej autorizim nga titullari i këtyre të drejtave për ta publikuar, dhe rrjedhimisht zbatohen kufizimet e nenit 17 të ligjit 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” (në vijim quajtur “Ligji për të Drejtën e Informimit”).

Pas parashtrimit të fakteve nga përfaqësuesi i Autoritetit Publik, u hartua procesverbali i cili u nënshkrua pa vërejtje prej tij.

Nga shqyrtimi i ankimit, kryerja e inspektimit, si dhe nga konsultimi i legjislacionit përkatës rezulton se, informacioni i kërkuar nga Z. , administrohet nga Autoriteti Publik në kuadër të një procedure prokurimi publik të ndërmarrë nga ky i fundit.

Rrjedhimisht, në shqyrtimin e çështjes gjejnë zbatim dhe dispozitat e Ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar (në vijim quajtur “Ligji për Prokurimin Publik”).

Pas shqyrtimit në tërësi të provave, Komisioneri konstaton se kërkesa për informacion nuk është trajtuar nga Autoriteti Publik brenda afatit të parashikuar në ligj, e provuar kjo jo vetëm nga pretendimet e ankuesit, por edhe nga verifikimet e kryera nga grupi i inspektimit pranë zyrave të Autoritetit Publik.

Siç është përmendur dhe më sipër, lidhur me çështjen në fjalë, përveç dispozitave të Ligjit për të Drejtën e Informimit gjejnë zbatim dhe dispozitat e legjislacionit të posaçëm, që në rastin konkret është Ligji për Prokurimin Publik.

Neni 21 i këtij ligji përcakton se informacioni i administruar sipas nenit 12 të tij, i vihet në dispozicion çdo personi të interesuar, palë në proces, me kërkesë të tij, pasi ka përfunduar klasifikimi ofertave.

Në bazë të nenit 12 të Ligjit për Prokurimin Publik, Autoriteti Publik duhet të mbajë procesverbale dhe dokumentacion të plotë për procedurat e kryera në përcaktimin e fituesit të kontratës, në mënyrë të tillë që të lejojnë kontrollin e zbatimit të ligjit.

Nga ana tjetër, neni 25 i Ligjit për Prokurimin Publik përcakton kufizime mbi Autoritetin Publik lidhur me publikimin e informacionit të marrë nga operatorët ekonomikë, të cilësuar si konfidencial, duke përfshirë në këtë kategori aspektet teknike, sekretet tregtare si dhe informacionet konfidenciale të ofertave.

Një kufizim i tillë përcaktohet dhe në pikën 1 (b) të nenit 17 të Ligjit për të Drejtën e Informimit.

Sa më sipër vlerësohet se kufizimet e pasqyruara në legjislacionin e zbatueshëm nuk prekin në mënyrë tërësore informacionin e kërkuar dhe rrjedhimisht refuzimi i dhënies së dokumentacionit është bërë në kundërshtim me pikën 6 të nenit 17 të Ligjit “Për të Drejtën e Informimit” i cili përcakton se: *“Nëse kufizimi prek vetëm një pjesë të informacionit të kërkuar, pjesa tjetër nuk i refuzohet kërkuarit. Autoriteti Publik tregon qartë pjesët e dokumentacionit përkatës që janë refuzuar, si dhe në bazë të cilës pikë të këtij neni është bërë ky refuzim”*.

Bazuar në nenin 15 të Ligjit “Për të Drejtën e Informimit”, Autoriteti Publik trajton kërkesën për informim brenda 10 ditëve pune nga data e dorëzimit të saj. Në çdo rast, mostrajtimi i kërkesës brenda këtij afati konsiderohet refuzim dhe bazuar në nenin 18, pika 2 a) e Ligjit për të Drejtën e Informimit përbën shkelje administrative.

Për sa më lart personat përgjegjës për dhënien e informacionit të kërkuar duhet të procedojnë me dhënien e informacionit/dokumentacionit duke zbatuar në mënyrë specifike kufizimet e përcaktuara në pikën 1 të nenit 17 të Ligjit për të Drejtën e Informimit si dhe ato të përcaktuara në nenin 25 të Ligjit “Për Prokurimin Publik”.

Theksojmë, se e drejta për t’u informuar është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funkcionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

Në këto kushte, në lidhje me ankimin e Z. _____, përfaqësuar me Autorizim nga Z. _____, kundër Autoritetit Publik, Komisioneri vlerëson se duke pasur parasysh sa është parashtruar më sipër lidhur me kufizimet në dhënien e informacionit, ankimi duhet pranuar pjesërisht.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjën a) të pikës 2 të nenit 18, pikën 3 të nenit 18, pikën 4 të nenit 19, pikat 1 dhe 2 të nenit 21, nenin 22, shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, ligjin nr.10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr 49/2012 ‘Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative’, i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Pranimin në mënyrë të pjesshme të ankimit të Z. _____, nr. 64/2 datë 19.01.2017 kundër Autoritetit Publik “Korporata Elektroenergjetike Shqiptare”, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare”.
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik “Korporata Elektroenergjetike Shqiptare” për vënien në dispozicion të informacionit sipas kërkesës për informim duke zbatuar kufizimet e pikës 1 të nenit 17 të Ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” dhe ato të nenit 25 të Ligjit nr. 9643 datë 20.11.2011 “Për prokurimin publik” i ndryshuar brenda datës 10.03.2017
3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi.
4. Ky vendim u dha sot në datë 2 . 3 .2017.

